



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 09 mars 2012
Nr. ref.: RK205/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI-109/10

Parashtrues

Ismet Hebibi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë,
Ac. Nr. 317/07, të 12 nëntorit 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Ismet Hebibi, me vendbanim në Junik, Kosovë.

Vendimi i kontestuar gjyqësor

2. Vendimi i kontestuar gjyqësor është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ac. Nr. 317/07, i 12 nëntorit 2008, që parashtruesit të kërkesës iu dorëzua më 26 dhjetor 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta e tij pasi rasti i tij është zgjatur katër vjet në Gjykatën Komunale në Deçan sepse një gjyqtar, “për shkaqe personale, u përpoq ta minimizonte rastin e tij dhe të nxirrte vendim të paligjshëm”.
4. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta urdhërojë kompensimin e dëmit që gjoja i është shkaktuar atij për shkak se ka më tepër se 40 vjet që trafostacioni i energjisë elektrike është vendosur në pronën e tij të paluajtshme. Parashtruesi, gjithashtu kërkon që Gjykata ta urdhërojë largimin e kabllos së tensionit të lartë dhe të trafostacionit të prishur të energjisë elektrike, i cili paraqet rrezik të madh për familjen e tij.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 tetor 2010. Parashtruesi kërkoi në kërkesë që identiteti i tij të mos zbulohet në vendimin e Gjykatës.
7. Më 23 nëntor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 109/10, e caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 109/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
8. Më 18 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve siç janë paraqitur nga parashtruesi

9. Parashtruesi është pronar i paluajtshmërisë Nr. 1342, lista poseduese 109, komuna e Junikut.
10. Sipas tij, prej vitit 1968 e deri më sot familja e tij dhe shumë familje të tjera janë rrezikuar për shkak se trafostacioni i energjisë elektrike ishte vendosur kundër dëshirës së familjes së tij në pronën e tyre të paluajtshme të përmendur më lart. Ky trafostacion ishte prishur shumë herë dhe prandaj paraqet rrezik për familjen e tij. Me një rast, tensioni i lartë ia mbyti një lopë në oborr.
11. Përveç dëmit material, frikës dhe shqetësimit psikologjik që ai dhe familja e tij kanë pësuar, më 18 prill 2008, trafostacioni i KEK-ut ishte shkatërruar nga stuhia dhe kabloja e tensionit të lartë ishte këputur dhe kishte rënë në dy shtëpi dhe në oborret e tyre.
12. Kjo situatë ka vazhduar për 42 vjet me radhë.

13. Si rrjedhojë, parashtruesi ngriti padi kundër KEK-ut në Pejë në Gjykatën Komunale në Deçan, duke kërkuar kompensimin e dëmit në shumë prej 17,230 eurove.
14. Më 19 qershor 2007, Gjykata Komunale në Deçan nxori Aktgjykimin C. Nr. 484/04 dhe e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazë, siç u cek më lart.
15. I pakënaqur me atë aktgjykim, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
16. Më 12 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin Ac. Nr. 317/07 dhe e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazë.
17. Sipas dëftesës së Gjykatës Komunale, që u gjet në dosjen e lëndës së parashtruesit, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, i 12 nëntorit 2008, i ishte dorëzuar parashtruesit më 26 dhjetor 2008.
18. Parashtruesi kërkoi së paku pesë herë përjashtimin e kryetarit të trupit gjykues nga rasti i tij në Gjykatën Komunale në Deçan, C. Nr. 448/04, për shkak të mungesës së kredibilitetit të gjyqtarit. Për më tepër, parashtruesi kërkoi që rasti i tij të kalohej në Gjykatën Komunale në Pejë apo në Gjakovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
20. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili në pjesën përkatëse thotë me sa vijon:

Afatet

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor....”

21. Gjykata vëren që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Qarkut të Pejës, Ac. Nr. 317/07, i 12 nëntorit 2008, i është dorëzuar parashtruesit më 26 dhjetor 2008. Gjykata, gjithashtu vëren që parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 29 tetor 2010.
22. Përveç kësaj, edhe po të supozohej që parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor, ai nuk ka treguar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës. (*shih mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679100, Vendim i 28 prillit 2004, shih gjithashtu mutatis mutandis, Vendimi i 24 marsit 2010 në rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor*).
23. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 49, 56 dhe 58 të Ligjit dhe nenin 36 1 (b) të Rregullores së punës, më 18 maj 2001, Gjykata Kushtetuese njëzëri


VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË si të pabazë kërkesën për moszbulim të identitetit të tij;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani